



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 99, datë 27.12.2006

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

“Mbi llogaritjen e normave fikse të interesit në tregun ndërbankar të parasë”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 2 dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe Statutit të Bankës së Shqipërisë i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë rregulloren “Mbi llogaritjen e normave fikse të interesit në tregun ndërbankar të parasë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare si dhe strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.¹

SEKRETARI

KRYETARI

Ylli Memisha

Ardian Fullani

¹ Buletini Zyrtar i Bankës së Shqipërisë që përmban vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.99, dt.27.12.06 është botuar në date 15.01.2007.

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

RREGULLORE

**“MBI LLOGARITJEN E NORMAVE FIKSE TË INTERESIT NË TREGUN
NDËRBANKAR TË PARASË”**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së llogaritjes së normave fikse të interesit të vendosjes dhe të pranimit të depozitave në tregun ndërbankar të parasë, të cilat përdoren nga Banka e Shqipërisë dhe nga të interesuarit për qëllime referuese, statistikore, vlerësuese dhe kontabilizuese.

**Neni 2
Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në zbatim dhe në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 3, paragrafi 2 dhe neni 43, shkronja “C”.

**Neni 3
Përkufizime**

Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **“TRIBOR”** (*Tirana interbank offer rate*) – është norma fikse e interesit e llogaritur bazuar në kuotimet e bankave referencë për të vendosur depozita në tregun ndërbankar të parasë.
2. **“TRIBID”** (*Tirana interbank bid rate*) – është norma fikse e interesit e llogaritur bazuar në kuotimet e bankave referencë për të pranuar depozita në tregun ndërbankar të parasë.
3. **“Kuotim”** – është norma e interesit nëpërmjet të cilit banka e nivelit të dytë shpreh gatishmërinë për të vendosur depozitë dhe për të pranuar depozitë në tregun ndërbankar të parasë. Kuotimi shprehet me dy shifra pas presjes dhjetore.

4. **“Bankë referencë”** – janë bankat e nivelit të dytë, mbi kuotimet e të cilave bazohet llogaritja e TRIBOR-it dhe TRIBID-it.
5. **“Tregu ndërbankar i parasë”** – është tregu ku bankat e nivelit të dytë kryejnë ndërmjet tyre veprime huamarrjeje dhe huadhënieje në monedhën vendase-lek.
6. **“Interesi i transaksionit me maturim njëditor”**- është norma e interesit për transaksionet, klerimi i llogarive i të cilit bëhet në ditën e marrëveshjes për kryerjen e transaksionit dhe veprimi i anasjelltë bëhet ditën pasardhëse të tij.
7. **“Interesi i transaksionit me maturim njëjavor”**- është norma e interesit për transaksionet, klerimi i llogarive i të cilit bëhet deri në 2(dy) ditë më vonë se dita e marrëveshjes për kryerjen e transaksionit dhe veprimi i anasjelltë bëhet një javë pas ditës së klerimit fillestar të llogarive.
8. **“Interesi i transaksionit me maturim 1-mujor”** – është norma e interesit për transaksionet, klerimi i llogarive i të cilit bëhet deri në 2(dy) ditë më vonë se dita e marrëveshjes për kryerjen e transaksionit dhe veprimi i anasjelltë bëhet një 1(muaj) pas ditës së klerimit fillestar të llogarive.
9. **“Interesi i transaksionit me maturim 3-mujor”** - është norma e interesit për transaksionet, klerimi i llogarive i të cilit bëhet deri në 2(dy) ditë më vonë se dita e marrëveshjes për kryerjen e transaksionit dhe veprimi i anasjelltë bëhet 3(tre) muaj pas ditës së klerimit fillestar të llogarive.
10. **“Interesi i transaksionit me maturim 6-mujor”** - është norma e interesit për transaksionet, klerimi i llogarive i të cilit bëhet deri në 2(dy) ditë më vonë se dita e marrëveshjes për kryerjen e transaksionit dhe veprimi i anasjelltë bëhet 6(gjashtë) muaj pas ditës së klerimit fillestar të llogarive.
11. **“Interesi i transaksionit me maturim 12-mujor”** - është norma e interesit për transaksionet, klerimi i llogarive i të cilit bëhet deri në 2(dy) ditë më vonë se dita e marrëveshjes për kryerjen e transaksionit dhe veprimi i anasjelltë bëhet 12(dymbëdhjetë) muaj pas ditës së klerimit fillestar të llogarive.

Neni 4

Përzgjedhja e bankave referencë

1. Departamenti i Operacioneve Monetare i përzgjedh bankat reference mbi bazën e kritereve të mëposhtme:
 - a) vëllimit të veprimeve në tregun ndërbankar të parasë; dhe

- b) gatishmërisë së bankave për të bërë/kryer veprime në tregun ndërbankar të parasë, duke respektuar normat e interesit të kuotuarra prej tyre.
2. Veprimet e bankave referencë në tregun ndërbankar të parasë së bashku, duhet të përbëjnë të paktën 85 (tetëdhjetepesë) për qind të vëllimit total të transaksioneve në tregun ndërbankar, në tremujorin e fundit.
3. Lista e bankave referencë publikohet nga Banka e Shqipërisë në faqet e saj në REUTERS, çdo ditë në orën 11:00.

Neni 5

Publikimi i kuotimeve të bankave

1. Kuotimet për llogaritjen e normave fikse TRIBOR dhe TRIBID, publikohen nga bankat referencë në faqet e tyre në REUTERS, çdo ditë midis orës 12:00 – 12:15 sipas orës lokale. Në rast të problemeve teknike, bankat referencë informojnë Bankën e Shqipërisë lidhur me kuotimet e tyre nëpërmjet faksit, e-mail-it dhe Reuters *dealing*.
2. Departamenti i Operacioneve Monetare kontrollon kryerjen e kuotimit dhe zgjidh çdo problem që mund të ketë me bankën referencë në intervalin kohor: 12:15 - 12:30.

Neni 6

Mënyra e llogaritjes së normave fikse të interesit

1. Departamenti i Operacioneve Monetare llogarit normat fikse TRIBOR dhe TRIBID në intervalin kohor : 12:30 – 13:00, sipas mënyrave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
2. Normat fikse TRIBOR dhe TRIBID sipas pikës 1 të kësaj rregulloreje llogariten për transaksionet me maturim si vijon:
 - a) 1-(një) ditë;
 - b) 1-(një) javë;
 - c) 1-(një) muaj;
 - ç) 3 - (tre) muaj;
 - d) 6 -(gjashtë) muaj;
 - dh)12- (dymbëdhjetë) muaj.
3. Normat fikse TRIBOR dhe TRIBID llogariten si mesatare aritmetike e thjeshtë dhe e rrumbullakosur deri në 2(dy) shifra pas presjes dhjetore, në mënyrat si vijon:

- a) në rast se publikimi i kuotimeve bëhet nga 8(tetë) ose më shumë banka nga lista e bankave referencë e shpallur nga Banka e Shqipërisë, norma fikse për maturimin përkatës sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni, është mesatarja aritmetike e thjeshtë të kuotimeve duke përjashtuar 2(dy) kuotimet më të larta dhe 2(dy) kuotimet më të ulta;
- b) në rast se publikimi i kuotimeve bëhet nga 6(gjashtë) ose 7(shtatë) banka nga lista e bankave referencë e shpallur nga Banka e Shqipërisë, norma fikse për maturimin përkatës sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni, është mesatarja aritmetike e thjeshtë të kuotimeve duke përjashtuar kuotimin më të lartë dhe kuotimin më të ulët;
- c) në rast se publikimi i kuotimeve bëhet nga 2(dy) deri në 5(pesë) banka nga lista bankave referencë e shpallur nga Banka e Shqipërisë, norma fikse për maturimin përkatës sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni, është mesatarja aritmetike e thjeshtë të të gjitha kuotimeve;
- d) në rast se publikimi i kuotimeve bëhet nga më pak se dy banka nga lista bankave referencë e shpallur nga Banka e Shqipërisë, norma fikse për maturimin përkatës sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni, nuk llogaritet.

Neni 7

Publikimi i normave fikse të interesit TRIBOR dhe TRIBID nga Banka e Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë publikon normat fikse të interesit – TRIBOR dhe TRIBID në faqen e saj në REUTERS dhe/ose në faqen e saj të internetit, menjëherë pas llogaritjes së tyre.
2. Mjetet e shpërndarjes së informacionit, të cituara në pikën 1, janë i vetmi burim zyrtar për publikun për marrjen e informacionit mbi normat fikse të interesit – TRIBOR dhe TRIBID.

Neni 8

Dispozita të fundit

1. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të nxjerrë nga lista e bankave referencë, për një afat kohor deri në një muaj, bankën, e cila:

- a) nuk i përmbahet kërkesave të kësaj rregulloreje në mënyrë të përsëritur; ose
 - b) manipulon kuotimin e saj për të influencuar qëllimisht normat fikse të interesit – TRIBID dhe TRIBOR.
2. Vendimi për nxjerrjen e bankës nga lista e bankave referencë merret nga Departamenti i Operacioneve Monetare.
 3. Departamenti i Operacioneve Monetare njofton me shkrim bankën përkatëse dhe Departamentin e Mbikëqyrjes, sipas pikës 2, duke paraqitur edhe arsyet e marrjes së këtij vendimi.
 4. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të saj në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI